



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Nr. Prot. 456 Dt 04.08.2014

Në bazë të konkursit të shpallur nga Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" të datës 11.07.2014, për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, për vitin akademik 2014/2015, Komisioni Qendror për zbatimin e konkursit dhe procedurën e shqyrtimit të kërkesave – ankesave, për Fakultetet në themel: Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Edukimit, mori këtë:

VENDIM

I

Komisioni gjatë shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave, ka konstatuar se në listat e shpallura me datën 25.07.2014 janë radhitur edhe kandidatët të cilët nuk e kanë kaluar pragun, andaj marr parasysh kriterin e konkursit "Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi në Fakultetet e sipërpërmendura kanë vetëm kandidatët që arrijnë 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues", Komisioni ka bërë përmirësimet e duhura dhe ka hartuar listën përfundimtare të kandidatëve të pranuar, listën e kandidatëve që nuk janë pranuar por që kanë arrit 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues dhe në fund listën e kandidatëve që nuk kanë arrit 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.

II

Komisioni vendosi që të pranohen edhe kandidatët që janë me pikë të barabarta me kandidatin e fundit të pranuar. Vendimi zbatohet për tri fakultetet.

III

Komisioni ka shqyrtuar 127 kërkesa – ankesa në tri fakultetet. Të gjitha kërkesat – ankesat e parashtruara nuk kanë pasur bazë juridike për ndryshim të rezultatit (rezultati i të gjitha këtyre testeve të shqyrtuara është rikonfirmuar), me përjashtim të dy rasteve me lëshime teknike në bazë të dokumentacionit të lëshuar nga shkolla e mesme, respektivisht dëftesat e klasave:

1. Valon Behxhet Musa, Fakulteti Ekonomik, Drejtimi; Banka, Financa dhe Kontabilitet. Pas verifikimit të suksesit në dëftesën e klasës së 10, kandidatit i shtohet një pikë (nga 3 pikë është ngritë në 4 pikë). Kështu që nga 54.5 pikë kandidati tani ka 55.5 pikë dhe hynë në listën e kandidatëve që pranohen.

2. Fidan Nasuf Bejta, Fakulteti i Edukimit; Programi Fillor. Pas verifikimit të suksesit në dëftesën e klasës së 10 dhe klasës së 13, kandidatit i shtohen dy pikë (një në kl. 10 nga 2 në 3

pikë dhe një në kl. 13, nga 2 në 3 pikë). Kështu që nga 59.5 pikë kandidati ka 61.5 pikë dhe hynë në listën e kandidatëve që pranohen.

ARSYETIM

Komisioni qendror për zbatimin e konkursit dhe procedurën e shqyrtimit të kërkesave – ankesave për Fakultetet në themel: Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Edukimit, pas shikimit të kërkesave – ankesave të kandidatëve, si në pikën I të vendimit, vërtetoi se kërkesat – ankesat lidhur me radhitjen e një numri të kandidatëve në listën prioritare edhe pse nuk kanë arritur 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues ishin të arsyeshme, prandaj këta kandidatë janë hequr nga lista e kandidatëve të pranuar apo të pa pranuar dhe janë radhitur në listën e kandidatëve që nuk kanë arritur 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.

Komisioni pasi analizoi kandidatët me pikë të barabarta me kandidatin e fundit të pranuar në tri fakultetet, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni qendror për zbatimin e konkursit dhe procedurën e shqyrtimit të kërkesave – ankesave për Fakultetet në themel: Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Edukimit, pasi shqyrtoi kërkesat – ankesat e parashtruesve një nga një, publikojë listat përfundimtare të kandidatëve të pranuar, të kandidatëve që nuk janë pranuar dhe kandidatëve që nuk e kanë kaluar pragun e provimit pranues.

Komisioni Qendror për zbatimin e konkursit dhe procedurën e shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave.

1. Prof. Ass. Dr. Alush Musaj _____
2. Prof. dr. Izet Zeqiri _____
3. Prof. ass. Rifat Morina _____
4. Prof. Dr. Qerim Selimi _____
5. Xhelal Smakiqi _____
6. Dr. sc. Mehush Aliu _____
7. Gani Selimi _____

